



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2583, datë 10.07.2015

Për

“Miratimin e dokumentit “Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj.Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar
5. Znj.Ketrin	Topçiu	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 10.07.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e dokumentit “Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike”.

BAZA LIGJORE:

- 1) Neni 7, neni 8 gërma p), neni 22 i Ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**).
- 2) Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”.
- 3) Udhëzuesi “Për procedurat e Këshillimit Publik”, miratuar me Vendim nr.1183, datë 10.03.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit (*Relacioni*),
2. Dokumenti “*Rregullore për pagesat në rastet për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike*”.
3. Dokumenti “Qëndrimi i AKEP për komentet e dërguara gjatë këshillimit publik”
4. Shkresa nr. 88/3 Prot., datë 02.06.2015 e sipërmarrësit Abissnet sh.a.
5. Shkresa nr. 88/4 Prot., datë 15.06.2015 e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a
6. Shkresa nr. 88/5 Prot., datë 19.06.2015 e sipërmarrësit Albtelecom sh.a.
7. Projekt Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;

si dhe duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Neni 22 i Ligjit 9918, përmban përcaktime për përdorimin e përbashkët të përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike, tubat e kabllave dhe kullat e antenave dhe faciliteteve dhe pajisjeve të tjera shoqëruese të tyre. Ky nen i ligjit 9918 përmban dhe përcaktime të tjera në lidhje me rastet e refuzimit dhe mos-marrvveshjeve për përdorimin e përbashkët të faciliteteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike, përfshirë për pagesat për këto shërbime, të cilat zgjidhen sipas rregullave të miratuara nga AKEP.
2. AKEP bazuar në rëndësinë e përdorimit eficient të infrastrukturës pasive të komunikimeve elektronike dhe me qëllim nxitjen e përdorimit të infrastrukturës pasive të ndërtuar nga operatorët e komunikimeve elektronike, me Urdhër nr. 1388, datë 15.01.2015 ngriti një Grup Pune për hartimin e rregullave për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës pasive.
3. AKEP me Vendimin nr.2568, datë 11.05.2015, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike-Këshillim Publik*”. Dokumenti u publikua në faqen e Internetit të AKEP dhe këshillimi publik u krye në periudhën 12.05.2015-11.06.2015.
4. Në fund të procesit të këshillimit publik në AKEP depozituan komente operatorët Abissnet, Vodafone Albania dhe Albtelecom:
 - a. Abissnet sh.a. me shkresën nr.3476, datë 2.06.2015 (ref. AKEP: nr.prot 88/3 datë 2.06.2015);

- b. Vodafone Albania sh.a. me shkresën me ref. LRD/0097/IK, datë 11.06.2015 (ref.AKEP nr.prot 88/4 datë 15.06.2015);
- c. Albtelecom sh.a. me shkresën nr.5028 Prot., datë 17.06.2015 (ref.AKEP nr.88/5, datë 19.06.2015).
5. Grupi i Punës i ngritur nga AKEP ka shqyrtuar dhe marrë në konsideratë komentet e palëve të interesuara duke reflektuar ndryshime në dokumentin përfundimtar *“Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe asetëve të rrjeteve të komunikimeve elektronike”*.
6. Dokumenti përfundimtar i përgatitur pas këshillimit publik *“Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe asetëve të rrjeteve të komunikimeve elektronike”*, është një rregullore që synon të plotësojë kuadrin ligjor dhe përmabn përcaktime në lidhje me:
- Parime të përgjithshme për përdorimin e infrastrukturës ku operatorët nxiten për të kryer negociata për këto shërbime si dhe ofrimin e tyre në baza transparente dhe jo-diskriminuese;
 - Mënyrën e përdorimit të përbashkët të tubacioneve duke dhënë specifikime se kush quhet hapësirë e lire dhe hapësirë shërbimi e nevojshme për mirëmbajtjen e kablllove ekzistuese, përdorimin e pusetave, metodat e mundshme për vendosjen e kablllove në tuba, etiketimin e kablllove etj.;
 - Procesin e lidhjes së marrëveshjes për përdorimin e përbashkët të tubacioneve dhe afatet përkatëse duke filluar nga kërkesa e operatorit përfitues deri në lidhjen e marrëveshjes dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nga AKEP;
 - Kushtet për përdorimin e përbashkët të kullave të antenave dhe procesin e lidhjes së marrëveshjes për përdorimin e përbashkët të kullave;
 - Kushtet për përdorimin e përbashkët të shtyllave;
 - Tarifat dhe pagesat për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës, dhe parimet për përcaktimin e tyre si transparenca, mos-diskriminimi, reciprociteti, arsyeshmëria, mënyrën e shprehjes së tarifave dhe llogaritjes së pagesave, si dhe se ku do bazohet AKEP për përcaktimin e tarifave në rast mosmarrëveshjes;
 - Pikat kryesore që duhet të ketë marrëveshja për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës si dhe detyrimin e operatorit të infrastrukturës që të depozitojë në AKEP një kopje të marrëveshjes së lidhur me operatorin përfitues;
 - Përcaktime për rregullimin e marrëdhënieve ekzistuese për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës.
7. Dokumenti është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor përkatës dhe ka marrë në konsideratë përvoja të ngjashme në vende të rajonit dhe BE.
8. Rregullat synojnë të lehtësojnë dhe nxisin marrëdhëniet për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës pasive, duke vendosur afate për trajtimin e kërkesave, parashikime për zgjidhjet teknike dhe mënyrën e përcaktimit të tarifave dhe pagesave dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar më lart, bazuar në nenin 110, 114, dhe në nenin 115 të ligjit nr.9918 datë 19.05.2008 i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP:

V E N D O S:

1. Të miratojë dokumentat:
 - a. *Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike.*
 - b. *Qëndrimi i AKEP për komentet e dërguara për dokumentin e nxjerrë në këshillim publik.*sipas tekstit bashkangjitur.
2. Ky Vendim dhe dokumentat e miratuar të publikohen në faqen e Internetit të AKEP www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R
Piro XHIXHO

ANËTARË:

Z.Alban KARAPICI

Znj.Anila DENAJ

Znj.Klarina ALLUSHI

Znj.Ketrin TOPCIU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RR E G U L L O R E

Nr. 35, datë 10.07.2015

PER

**“RREGULLA PËR PËRDORIMIN E PËRBASHKËT
TË FACILITETEVE DHE ASETEVE TË RRJETEVE
TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE PUBLIKE”**

MIRATUAR ME VKD NR.2583, DATE 10.07.2015

Neni 1

Objekti

Këto rregulla përcaktojnë parimet, përgjegjësitë dhe procedurat për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike (elementët pasivë) për sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve publike elektronike, si dhe mënyrën për përcaktimin e tarifave dhe pagesave për këto shërbime, në përputhje me nenin 22 të Ligjit 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, *i ndryshuar* (Ligji 9918).

Neni 2

Terma dhe Përkufizime

Pervec sa parashikohet ne nenin 3 te Ligjit “perkufizimet”, termat e meposhtem do te kene keto kuptime:

1. **Facilitete:** pjesë e infrastrukturës shoqëruese të komunikimeve elektronike, përfshin ndërtesën, pjesë të një ndërtese, apo mjediset e pavarura brenda një ndërtese ku janë instaluar pajisje të komunikimeve elektronike, si edhe elemente ndërtimore, të tilla si tubacione kabllore, shtylla, antena etj.
2. **Facilitetet shoqeruese:** janë ato shërbime shoqëruese, infrastruktura fizike dhe facilitete të tjera ose elemente të lidhura me një rrjet të komunikimeve elektronike dhe/ose një shërbim të komunikimeve elektronike, të cilat mundësojnë dhe/ose mbështesin ofrimin e shërbimeve nëpërmjet këtij rrjeti dhe/ose shërbimi ose kanë potencial për ta bërë këtë, e që përfshijnë, ndërmjet të tjerash, ndërtesat ose hyrjen në ndërtesa, kabllot e ndërtesave, antenat, kullat dhe ndërtime të tjera mbështetëse, kanalizime, tubacione, shtylla, puseta dhe kabinete.
3. **Tubacione të kabllave:** pjesë e infrastrukturës së rrjeteve të komunikimeve elektronike që përbëhen nga një rrjet i tubave nëntokësore të përbërë me materiale të përshtatshme, puseta dhe galeri tubacionesh, qëllimi i të cilave është instalimi dhe mbrojtja e kabllave të komunikimeve elektronike.
4. **Tuba (tubacione) kabllore në zona urbane:** tubacionet e instaluar në zona urbane si pjesë e rrjetit lokal.
5. **Tuba (tubacione) kabllore në zona ndërrurbane:** tubacionet e instaluar në zona ndërrurbane që lidhin distanca të gjata në rrugët kryesore të R.SH midis qyteteve/fshatrave
6. **Puseta:** dhoma nëntokësore me shumë qëllime të cilat janë të vendosura në vende të ndryshme ku tubacionet e kabllave kalojnë, kryqëzohen apo ndryshojnë drejtim dhe në afërsi të centraleve lokale;
7. **Shtyllat:** pjesë e infrastrukturës së rrjeteve të komunikimeve elektronike që përdoren për instalimin e infrastrukturës kabllore ajrore, për të lidhur distanca të gjata në rrugët kryesore të Republikës së Shqipërisë midis qyteteve /fshatrave

8. **Intenerar i tubacionit të kabllit:** një intenerar i projektuar apo ekzistues dhe një linje e pozicionuar gjeodizikisht i tubacioneve kabllore brenda korridorit të infrastrukturës së rrjetit të komunikimeve elektronike.
9. **Operatori i infrastrukturës:** Operatori i rrjetit të komunikimeve elektronike që zotëron tubin/tubacionet e kabllave, kullën e antenës apo elementë të tjerë të rrjetit ku do të vendosen kabllot ose pajisjet e sistemit radio të operatorit përfitues.
10. **Operator përfitues:** operatori që ka interes për përdorim të faciliteteve dhe aseteve të tubacioneve kabllore ose kullave të antenave të operatorit të infrastrukturës.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Sipërmarrësit e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike kanë detyrimin të trajtojnë kërkesat, të negociojnë dhe të ofrojnë shërbime të përdorimit të përbashkët të infrastrukturës në mirëbesim (good faith).
2. Operatori përfitues dhe operatori i infrastrukturës me qëllim arrijnë në marrëveshje për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës, fillimisht duhet të negociojnë me njëri tjetrin. Për të reduktuar mundësinë e dështimit të negociatave operatorët duhet të ndjekin përcaktimet e kësaj rregulloreje.
3. Shërbimet e përdorimit të përbashkët të infrastrukturës duhet të ofrohen nga operatori i infrastrukturës me tarifa të arsyeshme, në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese.
4. Shërbimet e përdorimit të përbashkët të infrastrukturës duhet të ofrohen në mënyrë që:
 - a. Të maksimizojnë përdorimin eficient të rrjeteve të komunikimeve elektronike
 - b. Të minimizojnë mundësinë për ndikime negative mjedisore
 - c. Të mundësojnë rritjen e konkurrencës në shërbimet e komunikimeve elektronike
5. Operatori i infrastrukturës mund të refuzojë kërkesën e operatorit përfitues për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve për arsye të mëposhtme:
 - a. Përdorimi i përbashkët i faciliteteve dhe aseteve është teknikisht i pamundur, bazuar në standardet kombëtare e ndërkombëtare të aplikueshme në RSH;
 - b. Përdorimi i përbashkët i faciliteteve dhe aseteve rrezikon të shkaktojë interferencë dhe/ose ndërhyrje serioze në shërbimet e komunikimeve elektronike të planifikuara të operatorit të infrastrukturës;
 - c. Në infrastrukturën fizike ekzistuese të operatorit të infrastrukturës nuk ka hapsirë të lirë të disponueshme për të hostuar elemente të rrjetit të operatorit përfitues duke marrë parasysh nevojat e ardhshme për hapsirë të operatorit të infrastrukturës të cilat janë të verifikueshme;
 - d. Përdorimi i përbashkët i faciliteteve dhe aseteve çënon integritetin dhe sigurinë e rrjetit të operatorit të infrastrukturës;
 - e. Pala që kërkon përdorim të përbashkët nuk pranon të paguajë tarifat e përcaktuara nga operatori i infrastrukturës.

6. Në rast të dështimit të negociatave apo mos-marrëveshjeve të tjera të lidhura me përdorimin e përbashkët të infrastrukturës, secila palë mund t'i drejtohet AKEP për zgjidhjen e mos-marrëveshjes sipas procedurave dhe afateve të parashikuara në Ligjin 9918, datë 19.05.2008, "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, kësaj rregulloreje dhe legjislacionit përkatës të aplikueshëm. Moszbatimi i këtyre Rregullave përbën shkelje të nenit 22 të Ligjit 9918/2008 i ndryshuar.

Neni 4

Përdorimi i përbashkët i Tubacioneve të Kabllove

1. Përdorimi i tubacioneve të kabllave do të kryhet në të gjitha nivelet e rrjetit të komunikimeve elektronike duke përdorur teknologji që mundësojnë përdorimin maksimal të arsyeshëm të hapësirës së lirë bazuar në parimin e barazisë dhe përdorimit të përbashkët.
2. Hapësirë e lirë në tuba të operatorit të infrastrukturës nënkupton:
 - a. hapësirën që nuk është e zënë nga ndonjë kabëll ekzistues;
 - b. hapësirën e zënë nga një kabëll i një operatori tjetër që parashikohet të hiqet brenda afatit të plotësimit të kërkesës së operatorit përfitues,
 - c. hapësirat/tubat që operatori i infrastrukturës ka detyrim sipas legjislacionit dhe lejeve të marra t'i japë për përdorim për palë të treta;të cilat nuk janë parashikuar si hapësirë shërbimi e nevojshme për mirëmbajtjen e kabllave ekzistues apo të hapësirës që është planifikuar nga operatori i infrastrukturës për vendosjen e kabllave të veta brenda 24 muajve të ardhshëm për zhvillimin e rrjetit të vet. Kjo e fundit duhet të justifikohet me dokumnetacion përkatës nga operatori i infrastrukturës.
3. Hapësirë e nevojshme për shërbimin e mirëmbajtjes së kabllave ekzistues nënkupton hapësirën që është e mjaftueshme për tërheqjen e kabllit me diametrim më të madh në pjesën përkatëse të tubit të kabllave.
4. Hapësirë e lirë në pusetë nënkupton hapësirën e mjaftueshme për të vendosur në pusetë lidhësit e kabllave me elementët e nevojshëm rezervë (për kabllot optikë pranohet deri në 25 m) pa krijuar probleme për aksesin në elementët rezervë/zgjidhës të kabllave ekzistues.
5. Nëse ka hapësirë të lirë në tub por jo në pusetë, atëherë elementët rezervë të kabllit të operatorit përfitues mund të vendosen në një kabinet pranë pusetës. Operatori përfitues ka detyrimin të marrë lejet përkatëse për këtë kabinet dhe të përballojë kostot përkatëse.
6. Nëse lejet përkatëse ndërtimore për kabinetin nuk mund të sigurohen atëherë nga palët mund të vlerësohet zgjerimi i pusetës dhe kostot shtesë shoqëruese përballohen nga operatori përfitues.

7. Teknologjitë dhe standardet e përdorura për përdorim eficient të përbashkët të tubave të operatorit të infrastrukturës duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi në RSH dhe përcaktimet e kësaj rregulloreje, përfshirë kriteret e mëposhtëme:
- a. Nëse për një segment/intenerar të caktuar të tubave kërkesa e operatorëve përfitues është më e madhe se kapaciteti i lirë i tubave të disponueshëm të operatorit të infrastrukturës, ky i fundit ka detyrimin t'i japë prioritet kabllave të fibrave optike dhe me kapacitet (numër fije) më të lartë dhe më pas kabllave të bakrit përsëri duke dhënë prioritet kapacitetit më të madh me diametrin më të vogël.
 - b. Brenda një tubi kabllot mund të vendosen (futen) sipas zgjedhjes së operatorit përfitues dhe kërkesave teknike të operatorit të infrastrukturës në:
 - i. Nën-tuba të vecantë (cdo kabëll në një nën-tub me diametër më të vogël se tubi kryesor);
 - ii. Direkt brenda tubit pa nën-tuba (disa kablo brenda një tubi)
 - iii. kombinime të dy mënyrave të mësipërme
 - c. Përveç rasteve kur palet bien dakord ndryshe ose ka pengesa teknike specifike operatori përfitues do të kryejë punimet për instalimin (futjen) e kabllave dhe/ose tubave në tubacionet e operatorit të infrastrukturës. Në cdo rast kostot e punimeve të instalimit si me lart përmendur do të perballohen plotësisht nga operatori përfitues. Operatori që kryen punimet është përgjegjës për cdo demtim të kabllave/nën-tubave apo pajisjeve të tjera të operatorit të infrastrukturës apo operatoreve të tjere.
 - d. Në rastet kur në një tub ka mundësi teknike të vendosen më shumë se një kabëll/nën-tub, seksioni i tubit të operatorit të infrastrukturës i përdorur nga operatori përfitues për përcaktimin e pagesës së qirasë së përdorimit të përbashkët dhe hapësirës së nevojshme për mirëmbajtje llogaritet në cm^2 si më poshtë:
 - i. Diametri i jashtëm i nën-tubit në katror (Φ^2) nëse kabli vendoset në nën-tub brenda tubit kryesor;
 - ii. Diametri i jashtëm i kabllit në katror (Φ^2) nëse kabli vendoset në tub direkt pa nën-tub.
 - iii. Në cdo rast shumatorja e sipërfaqeve të kabllave/nën-tubave të llogaritura si më sipër nuk duhet të jetë më e madhe se diametri i brendshëm i tubit në katror.
8. Cdo kabëll apo nën-tub duhet të ketë një etiketë në cdo pusetë. Etikata përmban tipin e kabllit/nën-tubit dhe operatorin zotërues të tij.

Neni 5

Procedura për lidhjen e marrëveshjes për përdorimin e përbashkët të tubacioneve

1. Operatori përfitues i drejton një kërkesë me shkrim Operatorit të Infrastrukturës për përdorimin e përbashkët të tubave kabllorë për të cilat është i interesuar.
2. Operatori i infrastrukturës brenda **30 ditëve** nga marrja e kërkesës, informon me shkrim (komunikim me shkresë/email) operatorin përfitues në lidhje me mundësinë ose pamundësinë e përdorimit të përbashkët të tubave kabllorë në intenerarin në fjalë.
3. Nëse rezulton se përdorimi i përbashkët i infrastrukturës është i mundshëm në të gjithë intenerarin e kërkuar, operatori i infrastrukturës dhe operatori përfitues lidhin marrëveshje për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të tubave kabllorë brenda 30 ditëve nga data e përgjigjes për pranimin e kërkesës referuar në pikën 2 të këtij neni. Marrëveshja përmban si aneks dhe pjesë të saj një plan të detajuar teknik në format .dwg (autocad).
4. Plani teknik i referuar në pikën 3 të këtij neni duhet të jetë në përputhje me këto rregulla dhe të përmbajë:
 - a. Specifikime teknike të planit teknik në fjalë
 - b. Situatën aktuale të sistemit të tubave përkatës
 - c. Vendndodhjen e secilës pusetë
 - d. Distancat midis qendrave të pusetave të vecanta
 - e. Numrin dhe llojin e tubave midis pusetave
 - f. Mënyrën dhe pozicionin e futjes së kabllorëve të operatorit përfitues përgjatë pusetave dhe intenerarit të tubave sipas kërkesës së operatorit përfitues.
 - g. Listën (preventivin) me materiale dhe punime të nevojshme për t'u kryer për futjen e kabllit të operatorit përfitues, duke përfshirë dhe llojin dhe sasinë e tyre, nëse futja e kabllit kryhet pa tub të vecantë.
 - h. Listën (preventivin) me materiale dhe punime për vendosjen e tubave brenda tubit të operatorit të infrastrukturës, dhe studimit për të bërë këto punime.
 - i. Në rast se punimet kryhen nga operatori përfitues për pikat 'g' dhe 'h' më sipër mjafton përshkrimi i punimeve që do të kryhen për futjen e kabllorëve dhe tubave dhe lista e të gjitha materialeve që do të perdoren.
5. Nëse kërkesa e operatorit përfitues nuk mund të plotësohet nga operatori i infrastrukturës, ky i fundit në përgjigjen me shkrim për mospranimin e kërkesës përfshin një shpjegim për pamundësinë e plotësimit të kërkesës, e cila duhet të jetë specifike për çdo facilitet/aset dhe e argumentuar qartësisht sipas përcaktimeve në nenin 3 pika 5 të kësaj rregulloreje.
6. Nëse operatori përfitues nuk është i kënaqur me shpjegimin e refuzimit të kërkesës brenda 30 ditëve nga data e refuzimit ai mund të kërkojë nga AKEP fillimin e procedurës për zgjidhje të mos-marrëveshjes dhe përcaktimin ose jo të kushteve për përdorimin e përbashkët të tubacioneve të kërkuara.

7. AKEP në përfundim të procedurës përcakton ekzistencën ose jo të kushteve për përdorimin e përbashkët të tubacioneve, nëpërmjet një vendimi i cili detyron operatorin e infrastrukturës plotësimin e kërkesës nëse ekzistojnë kushtet e tilla.
8. Në rast se operatori i infrastrukturës nuk kthen përgjigje brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës së operatorit përfitues, kjo do të konsiderohet si refuzim i operatorit të infrastrukturës për të dhënë akses për përdorim të përbashkët të infrastrukturës dhe përbën shkelje të nenit 22 të Ligjit 9918, dhe operatori përfitues ka të drejtë të kërkojë fillimin e procedurave në AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 6

Kushtet për përdorimin e përbashkët të shtyllave

1. Operatori përfitues depoziton një kërkesë me shkrim tek operatori i infrastrukturës për përdorimin e përbashkët të shtyllës/shtyllave për instalimin e rrjetit të tij kabllor, për të lidhur një distancë të caktuar.
2. Kërkesa e operatorit përfitues duhet të përmbajë sa më poshtë vijon:
 - a. Distancën dhe vendodhjen e shtrirjes së rrjetit kabllor ajror;
 - b. Numrin dhe llojin e saktë të kablllove/fibrave që do të instalohen;
 - c. Hapsirën e nevojshme për vendosjen e kablllove;
 - d. Afatet kohore për fillimin dhe kohëzgjatjen e përdorimit të përbashkët të infrastrukturës.
 - e. Çdo informacion tjetër të nevojshëm dhe të arsyeshëm për të mundësuar instalimin e rrjetit kabllor.
3. Operatori i infrastrukturës duhet të njoftojë operatorin përfitues, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së referuar në pikën 1 të këtij neni, për mundësinë ose pamundësinë e përdorimit të përbashkët të shtyllës.
4. Nëse operatori i infrastrukturës pranon kërkesën e operatorit përfitues ai i dorëzon operatorit përfitues kontratën e propozuar për përdorimin e përbashkët të kullës së antenës dhe gjithë dokumentacionin e disponueshëm të projektit
5. Në rastin e pikës 4, operatori përfitues duhet të përgatisë dokumentacionin në përputhje me kuadër ligjor në fuqi. Operatori përfitues do të sigurojë materialet dhe pajisjet dhe punimet që do kryhen nën mbikqyrjen e operatorit të infrastrukturës ose të një eksperti të autorizuar të miratuar nga operatori i infrastrukturës dhe këto kosto mbulohen nga operatori përfitues
6. Rrjeti kabllor i instaluar do të etikohet në mënyrën e duhur për të treguar llojin dhe pronarin e tij
7. Nëse kërkesa e operatorit përfitues nuk mund të plotësohet nga operatori i infrastrukturës, ky i fundit në përgjigjen me shkrim për mospranimin e kërkesës përfshin

një shpjegim për pamundësinë e plotësimit të kërkesës, e cila duhet të jetë specifike për çdo facilitet/aset dhe e argumentuar qartësisht sipas përcaktimeve në nenin 3 pika 5 të kësaj rregulloreje

8. Nëse operatori përfitues nuk është i kënaqur me shpjegimin e refuzimit të kërkesës ai mund të kërkojë nga AKEP fillimin e procedurës për përcaktimin ose jo të kushteve për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës së kërkuar.
9. AKEP në përfundim të procedurës përcakton ekzistencën ose jo të kushteve për përdorimin e përbashkët të shtyllës nëpërmjet një vendimi i cili detyron operatorin e infrastrukturës për plotësimin e kërkesës nëse ekzistojnë kushtet e tilla.
10. Në rast se operatori i infrastrukturës nuk kthen përgjigje brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës së operatorit përfitues, kjo do të konsiderohet si refuzim i operatorit të infrastrukturës për të dhënë akses për përdorim të përbashkët të infrastrukturës dhe përbën shkelje të nenit 22 të Ligjit 9918, dhe operatori përfitues ka të drejtë të kërkojë fillimin e procedurave në AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 7

Kushtet për përdorimin e përbashkët të kullave të antenave

1. Operatori përfitues depoziton një kërkesë me shkrim tek operatori i infrastrukturës për përdorimin e përbashkët të një kulle antene për instalimin e sistemit të tij radio, pajisjeve radio dhe pajisjeve terminale të telekomunikacioneve.
2. Kërkesa e operatorit përfitues duhet të përmbajë sa më poshtë vijon:
 - a. Lartësinë ku do të instalohet sistemi i tij i antenave dhe drejtimit
 - b. Numrin dhe llojin e saktë të antenave sipas drejtimit
 - c. Hapësirën e nevojshme për vendosjen e pajisjeve
 - d. Projektin konceptual që përmban:
 - Specifikimet teknike për bandën, frekuencën e operimit polarizimin, lartësinë e instalimit dhe drejtimin (azimuth), si dhe përmasat dhe peshën e antenës, sistemin e antenës dhe pajisjeve të tjera që janë objekt i kërkesës për përdorim të përbashkët
 - Kërkesa specifike për kapacitet transmetimi me propozimin përkatës për zgjidhje
 - Kërkesë specifike për akses në tubat ekzistues
 - Kërkesa specifike për energji elektrike, nëse ka mundësi për bashkvendosje të pajisjeve terminuese (në rast të kundërt furnizimi me energji do të kërkohej nga operatori i energjisë elektrike)
 - Kërkesa për energji ose kapacitete të tjera furnizuese lidhur me operimin e pajisjeve

- e. Afatet kohore për fillimin dhe kohëzgjatjen e përdorimit të përbashkët të infrastrukturës
 - f. Vërtetimin e autorizimit individual të përdorimit të frekuencave nga AKEP.
3. Operatori i infrastrukturës duhet të njoftojë operatorin përfitues, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së referuar në pikën 1 të këtij neni, për mundësinë ose pamundësinë e përdorimit të përbashkët të kullës.
 4. Nëse operatori i infrastrukturës pranon kërkesën e operatorit përfitues, ai i dorëzon operatorit përfitues kontratën e propozuar për përdorimin e përbashkët të kullës së antenës dhe gjithë dokumentacionin e disponueshëm të projektit.
 5. Në rastin e pikës 4, operatori përfitues duhet të përgatisë dokumentacion të ri të projektit, të bierë dakort me operatorin e infrastrukturës dhe të sigurojë të gjitha lejet përkatëse në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë. Operatori përfitues do të prokurojë materialet dhe pajisjet dhe punimet që do kryhen nën mbikqyrjen e operatorit të infrastrukturës ose të një eksperti të autorizuar të miratuar nga operatori i infrastrukturës dhe këto kosto mbulohen nga operatori përfitues.
 6. Të gjitha pajisjet e komunikimeve elektronike të instaluar do të etikohen në mënyrën e duhur për të treguar llojin dhe pronarin e pajisjes.
 7. Nëse kërkesa e operatorit përfitues nuk mund të plotësohet nga operatori i infrastrukturës, ky i fundit në përgjigjen me shkrim për mospranimin e kërkesës përfshin një shpjegim për pamundësinë e plotësimit të kërkesës, e cila duhet të jetë specifike për çdo facilitet/aset dhe e argumentuar qartësisht sipas përcaktimeve në nenin 3 pika 5 të kësaj rregulloreje
 8. Nëse operatori përfitues nuk është i kënaqur me shpjegimin e refuzimit të kërkesës ai mund të kërkojë nga AKEP fillimin e procedurës për përcaktimin ose jo të kushteve për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës së kërkuar.
 9. AKEP në përfundim të procedurës përcakton ekzistencën ose jo të kushteve për përdorimin e përbashkët të kullës së antenës, nëpërmjet një vendimi i cili detyron operatorin e infrastrukturës plotësimin e kërkesës nëse ekzistojnë kushtet e tilla.
 10. Në rast se operatori i infrastrukturës nuk kthen përgjigje brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës së operatorit përfitues, kjo do të konsiderohet si refuzim i operatorit të infrastrukturës për të dhënë akses për përdorim të përbashkët të infrastrukturës dhe përbën shkelje të nenit 22 të Ligjit 9918, dhe operatori përfitues ka të drejtë të kërkojë fillimin e procedurave në AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 8

Tarifat dhe pagesat për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës

1. Tarifat e aplikuara nga operatori i infrastrukturës për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës duhet të:

- a- Përcaktohen në mënyrë transparente: AKEP nëse është e nevojshme mund të kërkojë detaje të përcaktimit të tarifës/pagesës.
 - b- Jenë jo-diskriminuese: një ofrues i infrastrukturës aplikon kushte të njëjta në rrethana të njëjta në ofrimin e të njëjtit shërbim, si edhe tarifën që ofruesi i shërbimit ofron për veten, për një degë apo filial të tij.
 - c- Jenë reciproke për të njëjtin shërbim: kërkuesi dhe ofruesi i infrastrukturës paguajnë të njëjtën tarifë për shërbime të njëjta të ofruara njëri-tjetrit në kushte dhe rrethana të njëjta.
2. Tarifat e aplikuara rekomandohet të jenë të arsyeshme sipas kushteve lokale të Shqipërisë, të orientuara në kosto dhe të reflektojnë një normë të arsyeshme fitimi për operatorin e infrastrukturës, bazuar mbi kostot e punëve civile për projektimin, ndërtimin dhe shfrytëzimin eficient të infrastrukturës së tubacioneve kabllore.
 3. Operatori i infrastrukturës mund të aplikojë tarifa të arsyeshme orare për mbikqyrjen e punimeve nga ekspert/ekspertët e tij.
 4. Operatori i infrastrukturës është përgjegjës për mirëmbajtjen e infrastrukturës në përdorim të përbashkët, ndërsa operatori përfitues është përgjegjës për mirëmbajtjen e pajisjeve të veta. Operatori i infrastrukturës nuk është përgjegjës për çfaredolloj ndërhyrje që nuk varet nga Operatori i Infrastrukturës
 5. Tarifa dhe pagesa për qiranë mujore të përdorimit të tubacioneve nga operatori përfitues duhet të shprehen dhe llogariten nga operatori i infrastrukturës si më poshtë:
 - a. Tarifa shprehet në:
 - i. Lek/km/cm² për tubat me diametër 32 mm ose më të madh dhe/ose tubat ku ka mundësi teknike të vendosen disa kablllo/nën-tuba;
 - ii. Lek/km për tuba me diametër më të vogël se 32 mm dhe/ose tubat ku nuk ka mundësi teknike të vendoset më shumë se një kabëll;
 - iii. Tarifat sipas përcaktimeve ‘i’ dhe ‘ii’ më sipër specifikohen sipas diametrit të tubit që do ketë përdorim të përbashkët.
 - b. Pagesat për përdorimin e përbashkët llogariten mbi bazën e tarifave të shprehura si më sipër në pikën ‘a’ dhe përcaktimeve të mëposhtëme:
 - i. Pagesa mujore (P) për një kabëll/nën-tub (pika a/i më sipër) do të llogaritet $P=TxLxS$:
 - T: tarifa e shprehur në Lek/km/cm²
 - L: gjatësia e tubit të përdorur e shprehur në Km deri në 1 shifër pas presjes dhjetore.
 - S: sipërfaqja e seksionit të jashtëm të kabllit/nën-tubit e mmeasuret sipas përcaktimeve në pikën 7/d të nenit 4 dhe shprehet në cm² deri në 2 shifra pas presjes dhjetore;
 - ii. Pagesa mujore (P) për një kabëll të vendosur në një tub ku nuk mund të vendosen kablllo/nën-tuba të tjerë llogaritet $P=TxL$

- T: tarifa e shprehur në Lek/km
 - L: gjatësia e tubit të përdorur e shprehur në Km deri në 1 shifër pas presjes dhjetore.
- c. Në përlllogaritjen e pagesës për gjatësi të shkurtëra, operatori i infrastrukturës mund të përdorë si njësi minimale tarifimi gjatësi jo më të madhe se 100 m për zona urbane dhe 1Km për zona ndër-urbane.
6. Pagesat mund të llogariten në bazë mujore ose vjetore sipas përcaktimeve mësipërme dhe mënyra e pagesës dhe penaltitetet për mospagesë duhet të përfshihen në marrëveshje.
7. Palët duhet të negociojnë për pagesat/tarifat e aplikuar për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës. Në rast se palët nuk bien dakort për pagesat/tarifat dhe njëra palë ankohet në AKEP, sipas përcaktimeve të pikës 7 të nenit 22 të Ligjit 9918, AKEP në përcaktimin e tarifave do të marrë në konsideratë:
- a. Tarifat e aplikuar nga operatori i infrastrukturës për operatorë të tjerë në kushte dhe rrethana të njëjta apo të ngjashme;
 - b. Tarifa të aplikuar në ofertat referencë të operatorëve me FNT
 - c. Tarifat dhe metoda të aplikuar në vende të rajonit, BE dhe vende të tjera me zhvillim të ngjashëm me Shqipërinë. AKEP do të gjykojë rast pas rasti për nivelin/nivelet e tarifave benchmark për tu marrë në konsideratë në rast mos-marrveshjeje duke aplikuar parimet e konsistencës dhe arsyeshmërisë në përcaktimin e vlerave mesatare benchmark.
 - d. Orientimin në kosto të tarifave për përdorimin e përbashkët nga ofruesi i infrastrukturës, bazuar në parimet dhe rregullat e Rregullores nr.32, datë 26.12.2013 "Për ndarjen e llogarive...", duke përfshirë një normë të arsyeshme fitimi. Për këto shërbime do të aplikohen kostot historike dhe metoda FAC apo metoda të tjera të përcaktuara nga AKEP sipas rastit;
 - e. parimin e nxitjes së investimeve në infrastrukture dhe përdorimin e eficient të saj, si dhe realizimin e objektivave rregullatore të përcaktuara në Ligjin 9918/2008, i ndryshuar, dhe legjilaslacion tjetër përkatës të aplikueshëm.
8. AKEP në zgjidhjen e mosmarrveshjes për tarifat del me vendim i cili është i detyrueshëm për t'u aplikuar nga palët. Mos-zbatimi i tij nga operatori i infrastrukturës përbën shkelje të nenit 22 të ligjit 9918 dhe ndëshkohet me gjobë sipas parashikimeve të nenit 137 pika III/2 të Ligjit

Neni 9

Marrëveshja për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës

1. Nëse Operatori i infrastrukturës dhe operatori përfitues bien dakort apo detyrohen mbi bazën e një vendimi të AKEP për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës, ata do të

nënshkruajnë një marrëveshje për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës së kërkuar nga operatori përfitues.

2. Marrëveshja do të specifikojë pjesën e infrastrukturës që do të përdoret në mënyrë të përbashkët dhe plani teknik i hartuar në përputhje me këtë rregullore do të jetë pjesë e kontratës.
3. Marrëveshja të paktën duhet të përmbajë përcaktime në lidhje me :
 - a. Objektin e marrëveshjes;
 - b. Afatin e vlefshmërisë së kontratës;
 - c. Cmimet/tarifat për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës dhe mënyrën e pagesës së tyre;
 - d. Detyrimet e operatorit të infrastrukturës në lidhje me sigurinë e pajisjeve të instaluara;
 - e. Mënyra dhe procedura për mirëmbajtjen e infrastrukturës së instaluar;
 - f. Përgjegjësitë dhe mungesën e përgjegjësive të secilës palë për infrastrukturën e instaluar dhe atë në përdorim të përbashkët.
 - g. Raportimin e problemeve në pajisjet e instaluara dhe mënyra dhe afatet e eliminimit të problemeve;
 - h. Përfundimi, zgjidhja dhe anulimi i kontratës;
 - i. Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve.
 - j. Afatin minimal të kohezgjatjes së marrëveshjes.
 - k. Afate për kërkesa për zgjidhjen apo ndryshimet e kushteve të kontratës
 - l. Garanci Bankare nëse është e nevojshme për mbulimin e gjithë detyrimeve që mund t'i shkakohen rrejtë të Operatorit të Infrastruktura nga nderhyrja e Operatorit Përfitues, apo për demshperblimin për zgjidhjen e parakoheshme të Kontratës.
4. Operatori i infrastrukturës depoziton një kopje të marrëveshjes në AKEP brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i saj midis palëve.

Neni 10

Marrëdhëniet/ apo Marrëveshjet ekzistuese për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës

1. Marrëveshjet/marrëdhëniet ekzistuese midis operatorëve për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës do të modifikohen brenda **6 muajsh** nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje për të qenë në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje, përfshirë nënshkrimin e një marrëveshjeje nëse nuk ka të tillë.

2. Marreveshjet e parashikuara ne piken 1 te ketij neni, duhet te depozitohen në AKEP sipas pikës 4 të nenit 8;
3. Nëse në marrdhëniet ekzistuese operatorët nuk aplikojnë tarifa/faturim për shërbimet e përdorimit të përbashkët të infrastrukturës, ato duhet të përfshijnë tarifa në marreveshjen e lidhur sipas pikës 1 më sipër, duke zbatuar rregullat e legjislacionit perkates për faturimin e shërbimeve te ofruara njëri-tjetrit.

Neni 11

Hyrja ne fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga KD i AKEP.



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

**QËNDRIMI I AKEP PËR KOMENTET E KËSHILLIMIT PUBLIK PËR
DOKUMENTIN:**

“Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike-Këshillim Publik”

(MIRATUAR ME VKD NR.2583, DATE 10.07.2015)

AKEP me VKD Nr.2568, datë 11.05.2015 miratoi nxjerrjen në keshillim publik të dokumentit **“Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike-Këshillim Publik”**. Dokumenti u publikua në faqen e Internetit të AKEP www.akep.al dhe këshillimi publik zgjati 30 ditë në periudhën 12.05.2015-11.06.2015. Në përfundim të fazës së këshillimit publik në AKEP u depozituan komente nga Vodafone Albania, Abissnet dhe Albtelecom. AKEP falenderon operatorët e cituar më sipër për përfshirjen në procesin e këshillimit publik dhe për komentet e tyre.

Ky dokument përmban komentet e bëra me shkrim nga palët e interesuara gjatë keshillimit publik dhe qëndrimin e AKEP mbi keto komente.

Komente të Vodafone

Vodafone Albania shprehet se, në kuptim të nenit 22 dhe nenit 3 pika 4 dhe 5 e Ligjit 9918, i ndryshuar, facilitet si pjesë e infrastrukturës shoqëruese të komunikimeve elektronike konsiderohen edhe elementet ndërtimorë të tillë si shtyllat. Vodafone Albania sugjeron që pjesë e këtyre Rregullave të jetë edhe përcaktimi i kushteve të përdorimit të përbashkët të shtyllave, duke përfshirë përkufizim për 'shtyllat' dhe një nen të vecantë për përdorimin e përbashkët të shtyllave. Vodafone ka përfshirë në komente edhe tekstin përkatës për propozimet e bëra për shtyllat.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP gjykon se propozimi është i drejtë, dhe në versionin final të rregullores është përfshirë një nen i vecantë për përdorimin e përbashkët për shtyllat, bazuar në sugjerimin Vodafone. Përdorimi i përbashkët i shtyllave është parashikuar në nenin 6 që është nen shtesë, dhe nenet e tjera kanë ndryshuar numer respektivisht.

Komente të Vodafone

Në zbatim të nenit 22 pika 4 të Ligjit 9918/2008, i ndryshuar, Vodafone sugjeron që në këto Rregulla të detajohen rastet se kur mund të refuzohet një kërkesë për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve. Vodafone Albania propozon që në nenin 5 të shtohet pika 5 si më poshtë dhe pika 5 ekzistuese të bëhet pika 6:

"Operatori i infrastrukturës mund të refuzojë kërkesën e operatorit përfitues për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve për arsytet e mëposhtme. Përgjigja e operatorit të infrastrukturës për refuzimin duhet të jetë specifike për çdo facilitet/aset dhe e argumentuar qartësisht.

a) Përdorimi i përbashkët i faciliteteve dhe aseteve është teknikisht i pamundur, bazuar në standardet kombëtare e ndërkombëtare;

b) Përdorimi i përbashkët i faciliteteve dhe aseteve rrezikon të shkaktojë interferencë dhe/ose ndërhyrje serioze në shërbimet e komunikimeve elektronike të planifikuara të operatorit të infrastrukturës;

c) Në infrastrukturën fizike ekzistuese të operatorit të infrastrukturës nuk ka hapsirë të lirë të disponueshme për të hostuar elemente të rrjetit të operatorit përfitues duke marrë parasysh nevojat e ardhshme për hapsirë të operatorit të infrastrukturës të cilat janë të verifikueshme;

d) Përdorimi i përbashkët i faciliteteve dhe aseteve çënon integritetin dhe sigurinë e rrjetit të operatorit të infrastrukturës;

e) Pala që kërkon përdorim të përbashkët nuk pranon të paguajë tarifën e përcaktuara nga operatori i infrastrukturës.

Qëndrimi i AKEP

AKEP gjykon se komentet e Vodafone për këtë pikë janë të arsyeshme dhe në rregulloren finale është përfshirë teksti i propozuar.

Komente të Vodafone

Në mbështetje të parimeve të sanksionuara në Ligjin 9918/2008, i ndryshuar, dhe Kodin e Procedurës Administrative në fuqi, lidhur me afatet dhe procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis sipërmarresve, Vodafone Albania sh.a sugjeron, në fund të paragrafit të fundit të nenit 3 të shtohet fjalia: *Afatet dhe procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nga AKEP, ankimi dhe zbatueshmeria e vendimeve të AKEP si dhe penalitetet në rastin e shkeljeve respektive lidhur me këto Rregulla janë në përputhje me përcaktimet e Ligjit 9918/2008 i ndryshuar dhe Kodit të Procedurave Administrative. Moszbatimi i këtyre Rregullave përbën shkelje të nenit 22 të Ligjit 9918/2008 i ndryshuar.*

Qëndrimi i AKEP

AKEP ka bërë disa saktësime në paragrafin e komentuar të cilat pjesërisht marrin parasysh propozimin e Vodafone.

Komente të Vodafone

Vodafone Albania vlerëson *se përcaktimet e fjalisë së fundit të pikës 8 të nenit 7, të cilat sanksionohen në ligje të veçanta (respektivisht ligji 9918/2008 dhe Kodi i Procedurës Administrative), të hiqen.*

Qëndrimi i AKEP

AKEP në lidhje me sugjerimin sipërcituar, sqaron se përcaktimi në pikën 8 të nenit 7 sjell në vëmendje të palëve detyrimin e zbatimit të Vendimit të AKEP, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për tarifën, pasi edhe Ligji 9918 i ka dhënë rëndësi të veçantë mosmarrëveshjeve për tarifën duke parashikuar afat 1 muaj për zgjidhjen e tyre.

Keto përcaktime nuk heqin të drejtën që ka secila palë që të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes në Gjykatën Kompetente, sipas legjisllacionit në fuqi.

Komente të Vodafone

Në përputhje me standardet e njohura të instalimit, disa lloje tubash konsiderohen të zënë edhe pse aty kalon vetëm një kabëll. Me qëllim aplikimin e standardeve të njohura të instalimit (kombëtare e ndërkombëtare), Vodafone Albania sugjeron që në nenin 4 pika 2 paragrafi i fundit të shtohet: dhe nuk konsiderohen të lira në përputhje me standardet përkatëse të instalimit.

Vodafone Albania sugjeron, Neni 4 pika 2 paragrafi i fundit të bëhet: *të cilat nuk janë parashikuar si hapsirë shërbimi e nevojshme për mirëmbajtjen e kabllave ekzistues dhe nuk*

konsiderohen të lira në perputhje me standardet perkatese kombëtare e ndërkombëtare të instalimit"

Qëndrimi i AKEP:

AKEP ka pranuar te perfshije ne rregullore si arsye refuzimi rastet kur standardet kombetare/nderkombetare nuk lejojne perdorim te perbashket ten je facilitetit (neni 3, pika 5), dhe prandaj gjykon se nuk eshte e nevojshme shtesa e propozuar nga Vodafone ne nenin 4.

Komente të Vodafone

Në lidhje me përcaktimin e hapsirës së lire për të vendosur në pusetë lidhësit e kablllove me elementët e nevojshëm rezervë, në pikën 4 të nenit 4, duke pasur parasysh specifikat e Shqipërisë (kabllot optike keputen shume shpesh dhe për çdo keputje nevojitet 50 cm për të rilidhur kabllin), ***Vodafone Albania sugjeron*** që elementet e nevojshëm rezervë për kabllot optike të konsiderohen më shumë se 20 m. Vodafone Albania propozon që kjo të konsiderohet të paktën 30 m.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP ka marrë pjesërisht në konsideratë këtë koment, duke ndryshuar vlerën 20 m në 25m.

Komente të Vodafone

Vodafone vlereson se përveç rasteve kur palët bien dakord ndryshe dhe mund të ketë vështiresi teknike, është e drejte dhe detyrim i operatorit perfitues qe te kryeje punimet per instalimet lidhur me perdorimin e perbashket te tubacioneve te kablllove, me qellim menaxhimin dhe kontrollin e cilesise se instalimit. Vodafone sugjeron qe neni 4 pika 7.c te ndryshoje si vijon:

Pervec rasteve kur palet bien dakord ndryshe ose ka pengesa teknike specifike operatori perfitues do te kryeje punimet per instalimin (futjen) e kablllove dhe/ose tubave ne tubacionet e operatorit te infrastruktures. Ne cdo rast kostot e punimeve te instalimit si me lart permendur do te perballohen plotesisht nga operatori perfitues.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP pranon kete riformulim te Vodafone dhe e ka perfshire ate ne versionin final te rregullores.

Komente të Vodafone

Nisur nga praktika aktuale, vlereson se, per lidhjen e marreveshjes per perdorimin e perbashket te tubacioneve, nuk eshte i nevojshem preventivi i detajuar i te gjitha materialeve dhe punimeve te nevojshme per t'u kryer, por vetem nje pershkrim i punimeve qe do te kryhen dhe materialeve qe do te perdoren. Ne nenin 5 pika 4 V.A sugjeron qe germat g dhe h te zevendesohen me piken g si vijon: *Pershkrimi i punimeve qe do te kryhen per futjen e kablllove dhe tubave dhe lista e te gjitha materialeve qe do te perdoren.*

Qëndrimi i AKEP:

AKEP ka marre pjeserisht ne konsiderate propozimin e Vodafone, duke kufizuar formulimin e Vodafone vetem ne rastet kur punimet kryhen nga operatori perfitues. Ne rast se punimet kryhen nga operatori i infrastruktures dhe kostot e ketyre punimeve paguhen nga operatori perfitues, atehere ky i fundit ka nevoje per percaktimet e pikave 'g' dhe 'h' te nenit 5/4. AKEP ka shtuar nje paragraf shtese, me tekstin e meposhtem:

Në rast se punimet kryhen nga operatori përfitues për pikat 'g' dhe 'h' më sipër mjafton pershkrimi i punimeve qe do te kryhen per futjen e kablllove dhe tubave dhe lista e te gjitha materialeve qe do te perdoren.

Komente të Vodafone

Ne nenin 6 pika 2.d) (pika e pare), gjykon me qellim vleresimin e mundesise per perdorimin e perbashket te kullave te antenave, nisur edhe nga eksperiencia aktuale eshte e nevojshme qe te specifikohen edhe parametrat lidhur me banden, frekuencen e operimit, polarizimin, lartesine e instalimit dhe drejtimin (azimuth), te cilat V.A sugjeron qe te shtohen ne kete paragraf si vijon: Neni 6. pika 2.d (e pare): *"Specifikimet teknike per banden. frekuencen e operimit polarizimin. lartesine e instalimitdhe drejtimin (azimuth), si dhe permasat dhe peshen e antenes, sistemin e antenes dhe pajisjet e tjera qe jane objekt i kerkeses per perdorimin e perbashket.*

Sa i perket percaktimit ne nenin 6, pika 2.d, pika e katert duke qene se furnizimi me energji mund te behet edhe permes burimeve alternative te energjise (p.sh. transformatorit), sugjeron qe percaktimi ne kete pike te jete i natyres se pergjithshme, si vijon: Neni 6, pika 2.d (e katert): *Kerkesa per energji ose kapacitete te tjera furnizuese lidhur me operimin e pajisjeve.*

Qëndrimi i AKEP:

AKEP pranon propozimin e Vodafone dhe ne versionin final te rregullores ka perfshire dy formulimet e Vodafone per nenin 6.

Komente të Vodafone

Vodafone sugjeron qe ne nenin 7, ne zbatim te ligjit 9918/2008, i ndryshuar, modele te percaktimit te tarifave te jene ose "benchmarking" (tarifat e marra ne konsiderate nga AKEP per kete model jane ato te percaktuara ne nenin 7 pika 7.a, b dhe c, si dhe metoda e orientimit ne kosto, e percaktuar ne piken 7.e te nenit 7. Pika 7.d e nenit 7 (kostot e puneve civile per ndertimin e tubacioneve ne Shqiperi) jane pjese e metodologjise se orientimit ne kosto, dhe per kete arsye V.A sugjeron qe te hiqet. Sa i perket pikes 7.f dhe g te nenit 7, duke qene se perbejne parimet mbi te cilat mbeshtetet puna e AKEP bazuar ne ligjin 9918/2008, i ndryshuar, sugjerojme qe te perfshihen ne nje paragraf te vecante. Per sa me siper V.A sugjeron qe ne piken 7 te nenit 7 te behen ndryshimet e meposhtme:

Pika 7.d te hiqet

Pika 7.e) te ndryshohet si vijon:

"Orientimi ne kosto i tarifave per perdorimin e perbashket nga ofruesi i infrastruktures i kryer sipas nje metodologjie te vecante te llogaritjes se kostos se ofrimit eficient te sherbimeve, e cila do te konsultohet me pare me palet e interesuara ne konsultim publik ne perputhje me legjisacionin ne fuqi"

Pika 7.f dhe g bashkohen ne nje paragraf te vecante, si vijon: *"Ne procesin e percaktimit te tarifave, AKEP udhëhiqet nga parimi i nxitjes se investimeve ne infrastrukture dhe perdorimin eficient te saj, si dhe realizimi i objektivave rregullatore te tpercaktuara ne Ligjin 9918/2008, i ndryshuar.*

Qëndrimi i AKEP:

AKEP ka marre pjeserisht ne konsiderate sugjerimet e Vodafone, duke hequr piken 7/d dhe bashkuar pikat 7/f dhe 7/g, si dhe duke bere riformulim te pikes 7 ne disa pjese te saj. Ne piken 7/c te nenit 8 (me pare neni 7), AKEP ka bere nje riformulim per te saktësuar perdorimin e vlerave benchmark nga AKEP.

Komente të Vodafone

Vodafone sugjeron qe marreveshja midis operatorit te infrastruktures dhe operatorit perfitues eshte e nevojshme qe te permbaje procedurat per mirembajtjen e te gjithe infrastruktures se instaluar, jo vetem te pajisjeve te instaluara. Per kete V.A sugjeron qe neni 8 pika 3.e te ndryshoje si vijon: *"Menyra dhe procedura per mirembajtjen e infrastruktures se instaluar."*

Qëndrimi i AKEP:

AKEP pranon kete sugjerim dhe ka bere ndryshimin perkates ne rregullore.

Komente të Vodafone

VA sugjeron qe lidhur me zbatimin e percaktimeve te kesaj Rregulloreje per marredheniet ekzistuese, eshte e nevojshme qe te percaktohet nje periudhe tranzitore, ne vleresimin tone prej 1 (nje viti nga dita e hyrjes ne fuqi te kesaj Rregulloreje, me qellim dhenien e kohes se mjaftueshme per planifikimin, buxhetimin, pergatitjen e dokumentacionit dhe materialeve te nevojshme, si dhe rinegocimin e marreveshjeve nese do te jete e nevojshme.

Sa i perket tarifave ne marreveshjen midis paleve te percaktuar ne piken 3 te nenit 9, *Vodafone Albania*, vlereson se keto jane objekt i rregullimit nga legjislacioni tatimor ne fuqi, si dhe objekt i negociatave te lira midis paleve. Ne kete kuptim *Vodafone Albania*, sugjeron qe ky nen te hiqet pasi ceshtja ne fjale rregullohet nga nje ligj i vecante.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP pranon pjeserisht sugjerimin e pare te Vodafone (nga propozimi per 1 vit afat eshte lene 6 muaj afat) dhe nuk pranon sugjerimin e dyte per heqjen e pikes 3 te nenit 9. AKEP ka riformuluar kete pike per te saktësuar kuptimin e tij. Dy operatore mund te kene marreveshje reciproke per perdorim te perbashket, por ato duhet te perfshijne tarifa ne keto marreveshje dhe njekohesiht te faturojne njeri tjetrin sipas legjislacionit perkates ne fuqi. Mos-faturimi dhe/ose mos-perfshirja e tarifave ne marrevshje krijojne probleme te tilla si:

- Diskriminim midis operatoreve te ndryshem;
- Mundesi koluzioni apo marreveshje te fshehta midis paleve
- Mundesi per evazion fiskal dhe tregues jo te sakte (te shtremberuar) te te ardhurave nga komunikimet elektronike

Komente te Albtelecom

Në lidhje me hapësirën e lirë në tuba të operatorit të infrastrukturës, parashikuar për tu dhënë në përdorim të përbashkët, në përcaktimet e **nenit 4, pika 2** e draft rregullores, Albtelecom kërkon që të parashikohet si hapësirë e nevojshme edhe mundësia për projektet e zhvillimit të operatorit të infrastrukturës në mënyrë që ky i fundit të mund të shtrijë të paktën një kabëll për nevojat e veta në kuadër të projekteve të tij të zhvillimit. Kështu, Albtelecom sugjeron që, në **nenin 4, pika 2**, pas pikave a), b),c), pas fjalisë “...të cilat nuk janë parashikuar si hapësirë shërbimi e nevojshme për mirëmbajtjen e kablllove ekzistues” të shtohet në vijim të kësaj fjalisë si më poshtë:

“...të cilat nuk janë parashikuar si hapësirë shërbimi e nevojshme për mirëmbajtjen e kablllove ekzistues si dhe hapësirë zhvillimi e nevojshme për projektet e zhvillimit të operatorit të infrastrukturës”

Albtelecom këkon që çështja e hapësirës së nevojshme për projektet e zhvillimit të vetë operatorit të përkufizohet edhe në vijim të **pikës 3**, dhe të shtohet një pikë tjetër **3/1** si më poshtë:

“hapësirë zhvillimi e nevojshme për projektet e zhvillimit nënkupton hapësirën që është e mjaftueshme për shtrirjen të paktën e një kablli me diametër minimumi Ø2.5 cm në pjesën përkatëse të tubit të kablllove”

Po në këtë nen, në pikën 7 të tij, Albtelecom sugjeron të shtohet shkronja e) në vijim të shkronjave a),b),c) dhe d) ku të përcaktohet si kriter në ofrimin e shërbimeve të infrastrukturës edhe dimensionin e kabllit dhe nëntubave që kërkohen të shtrihen në infrastrukturën e operatorit të infrastrukturës.

Kjo kërkesë del e nevojshme për shkak se zhvillimet teknologjike në përdorimin e kablllove dhe nën-tubave nxisin nevojën e evitimit të përdorimit të kablllove apo nëntubave me seksione të dimensioneve të mëdha. Kjo, për shfrytëzimin sa më eficient të hapësirave të lira në mënyrë që të optimizohen në maksimum përdorimi i infrastrukturës së operatorit nga më shumë se një operator përfitues.

Gjithashtu, në vijim të pikës e), Albtelecom kërkon që të shtohet edhe një pikë tjetër f) ku të parashikohet se në rastin e kërkesave të operatorëve për nën tuba, kërkesa dhe vlerësimi do të gjykohet rast pas rasti varësisht gjëndjes së tubacionit dhe hapësirës së lirë në tubacionin ku kërkohet të instalohen (futen) këto nën-tuba. Kjo, për shkak të kompleksitetit që mund të shkaktojë jo vetëm për mirëmbajtjen por dhe për ndonjë kërkesë tjetër, pasi prezenca e kablllove dhe e nën-tubave të tjerë në tubacion vështirëson konsiderueshëm pothuasje çdo proces teknik apo punë në çdo rast që do ketë të bëjë me atë pjesë të tubacionit me prezencë të tilla (kablllo dhe nën tuba).

Albtelecom sugjeron që në **nenin 4, pika 7**, të shtohet **pika e) dhe f)** me përmbajtje si më poshtë:

e) *“Kabllot dhe/apo nën-tubat që do të lejohen/pranohen për tu për tu instaluar (fatur) në infrastrukturën e operatorit të infrastrukturës duhet të jenë të seksioneve me diametër jo më të madh se Ø2.5 cm për kabllot dhe jo më të madh se Ø3 cm për nën-tubat.”*

f) *“Kërkesa e operatorit për shtrirjen e nën-tubave do të gjykohet/vlerësohet duke marrë në konsideratë prezencën dhe nevojën për mirëmbajtjen e kabllave dhe/ose nën-tubave të tjerë dhe kjo kërkesë do të pranohet vetëm nëse nuk do të çënojë në atë masë sa të bëjë të pamundur vijueshmërinë apo proceset teknike dhe të punëve që kërkohen për prezencat ekzistuese në atë pjesë të tubacionit”*

Qëndrimi i AKEP

AKEP pranon sugjerimin e parë të Albtelecom për rastet kur një tub/hapesirë në të është planifikuar nga operatori i infrastrukturës për tu përdorur për rrjetin e vet. Megjithatë AKEP në riformulim ka përcaktuar kur plani është për 24 muajt e ardhshëm dhe operatori i infrastrukturës duhet të ketë dokumentacion të vertetë të këtyre. Për sa i përket kërkesave të Albtelecom për përcaktimin e dimensionit maksimal të kabllit/nën-tubit, AKEP nuk gjykon se është e nevojshme, pasi në bazë të përcaktimeve të nenit 8 të rregullores (neni 7 në draft rregullore) diametri i kabllit/nëntubit ndikon në pagesën e operatorit përfitues (diametri më i madh, pagesa më e madhe). Gjithashtu në pikën 7/a të këtij neni AKEP ka përcaktuar një prioritet për llojet e kabllave që duhet të vendosen në tuba, duke i dhënë përparësi fibrave optike. Njëkohësisht për propozimin për pikën 7/f AKEP ka përfshirë si arsye të refuzimit të kërkesës, rastin e cenimit të integritetit të rrjetit (që është edhe pjesë e ligjit), dhe nuk ka nevojë për përcaktime të tjera.

Komente të Albtelecom

Përsa i përket afateve të përcaktuara në **nenin 5** të draft rregullores për procesin e lidhjes së marrëveshjes për përdorimin e përbashkët të tubacioneve, në lidhje me afatin e specifikuar në **pikën 2 të këtij neni** për kthimin e përgjigjes kërkesës së operatorit, Albtelecom, duke konsideruar natyrën teknike të shërbimeve të infrastrukturës të cilat kërkojnë domosdoshmërisht edhe verifikime dhe vlerësime të detajuara që kërkojnë të paktën kohë fizike, gjykon se është e nevojshme një periudhë të paktën 30 ditore për operatorin e infrastrukturës për të analizuar/vlerësuar kërkesën e drejtuar ndaj tij në lidhje me mundësitë apo pamundësitë e ofrimit të shërbimit të kërkuar dhe kthimin e përgjigjes. Prandaj, **pika 2 e këtij neni (neni 5)** të cilësohet me *“...30 ditëve nga marrja e kërkesës...”*

Albtelecom kërkon që po në **pikën 2, të nenit 5**, pas togfjalëshit *“:...me shkrim...”* të shtohet edhe togfjalëshi *“...me shkrim/komunikim elektronik...”*. Kjo kërkesë e Albtelecom për të shtuar mundësinë e informimit të operatorit përfitues edhe nëpërmjet komunikimit elektronik nga ana e operatorit të infrastrukturës, vjen për të facilituar akoma më shumë procesin e komunikimit ndërmjet palëve dhe për të bërë këtë proces më fleksibël, vecanërisht në rrethanat kur pikërisht

operatori i infrastrukturës mund të jetë subjekt i një sërë kërkesash të njëkohshme që duhen vlerësuar dhe gjykuar dhe për të cilat duhet të informohet operatori kërkuar i shërbimit.

Gjithashtu, në po të njëjtin nen, në lidhje me afatin kohor për lidhjen e marrëveshjes, Albtetelecom kërkon rishikimin e **pikës 3 të këtij neni** si më poshtë:

“nëse rezulton se përdorimi i përbashkët i infrastrukturës është i mundshëm në të gjithë intenerarin e kërkuar, operatori i infrastrukturës dhe operatori përfitues lidhin marrëveshje për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të tubave kabllorë brënda 30 ditëve nga data e pranimit të ofertës pas informimit me shkrim nga ana e Operatorit të infrastrukturës në lidhje me kërkesën e operatorit përfitues të referuar në pikën 1 të këtij neni. Marrëveshja përmban si aneks dhe pjesë të saj një plan të detajuar teknik në format .dëg (autocad).”

Qëndrimi i AKEP

AKEP pranon sugjerimet e Albtetelecom dhe në versionin final të rregullores ka bërë ndryshimet përkatëse në nenin 5 dhe nenet e tjera që kanë përcaktime të ngjashme për afatin.

Komente të Albtetelecom

Përsa i përket elementëve që duhet të përmbajë plani teknik sipas parashikimeve në **nenin 5, pika 4**, Albtetelecom sugjeron se, si pjesë e të dhënave të vlerësuara të nevojshme për tu përfshirë në planin teknik për **pikën 4/e**, konkretisht të dhëna në lidhje me tubin që përdoret në pusetat e infrastrukturës do të ishte i mjaftueshëm vetëm informacioni për **“Llojin e tubave midis pusetave”**.

Qëndrimi i AKEP

AKEP pranon këto sugjerime të Albtetelecom dhe ka bërë ndryshimin përkatës.

Komente të Albtetelecom

Albtetelecom shpreh opinionin e tij në lidhje me formulimin e **pikës 8 të nenit 5**, sipas së cilës, mos respektimi i një termi procedural sic është afati i propozuar në draft rregullore, prej 30 ditësh, sanksionon/zyrtarizon apriori një shkelje ligjore të operatorit të infrastrukturës në referencë të nenit 22 të Ligjit. Së pari, mos respektimi i afatit 30 ditor cilësuar në këtë nen, mund të vijë për arsye nga më të ndryshmet apo më të rëndomtë deri në arsye të thjeshta burokratike apo administrative të cilat mund të mos jenë të lidhura aspak me vullnetin për të ofruar shërbimin apo për ta refuzuar atë.

Për më tepër, mos respektimi i afateve procedurale mund të pretendohet në cdo kohë nga pala pretenduese dhe të kërkohet zbatim i tyre sipas procedurave të parashikuara nga Ligji, për zgjidhjet e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve, procedura të cilat garantojnë të drejtat legjitime të palëve për të paraqitur argumentet/arsyetimet apo pretendimet/mbrojtjen e tyre.

Akoma më tej, nuk mundet që sanksione të tilla të shkeljeve të jenë më të rënda se sanksionet për raste analoge (*të respektimit të afateve procedurale*) për shërbime të tjera akoma më të rëndësishme se sa shërbimet e infrastrukturës apo nën rregullim, sic është rasti i ofrimit të aksesit dhe interkoneksionit në zbatim të nenit 42 të Ligjit. Kështu, për këto raste, Ligji parashikon se palët i drejtohen AKEP, dhe më tej AKEP ndjek procedurën përkatëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit, e cila në këtë fazë finalizohet maksimalisht me lëshimin e një Urdhëri nga AKEP për nënshkrimin e marrëveshjes.

Ndaj, për analogji, referenca në rastet e shërbimeve të interkoneksionit, si shërbim nën rregullim dhe me rëndësi të lartë për pajtimtarët, është maksimumi që duhet të konsiderohet kur kjo draft rregullore që po shqyrtohet kërkon të paraqesë si shkelje mosrespektimin e afateve për shërbimet e infrastrukturës. Ndërkohë që në cdo rast dhe në cdo lloj fushe të legjislacionit, nuk mund të sanksionohet apriori fajësia e një pale pa patur të drejtën për të dhënë shpjegimet e tij në një proces të rregullt administrativ dhe ligjor.

Së dyti, në kuptim të nenit 22 të Ligjit për Komunikimet Elektronike, refuzim i kërkesës për përdorim të përbashkët të infrastrukturës është i përcaktuar në pikën 4, shkronja a) dhe b) e tij dhe asnjë nga këto raste nuk lidhen me mos kthimin e përgjigjes brënda një afati të caktuar kohor.

Së fundi në lidhje me **pikën 8 të këtij neni**, duke mirëkuptuar qëllimin e AKEP për të nxitur ofrimin e këtyre shërbimeve dhe plotësimin e kërkesave të operatorëve për këto shërbime, dhe në referencë edhe të afatit 30 ditor të kërkuar për tu ndryshuar në pikën 2 të po këtij neni (*shih më lart: 30 ditë për kthim përgjigje*), Albtelecom kërkon që afati i cilësuar në **pikën 8 të nenit 5**, të jetë **45 ditë** dhe kjo pikë të riformulohet si më poshtë:

“Në rast se operatori i infrastrukturës nuk kthen përgjigje brënda 45 ditëve nga marrja e kërkesës së operatorit përfitues, operatori kërkon fillimin e procedurave në AKEP për të kërkuar zgjidhjen sipas parashikimeve në Procedurën për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”

Albtelecom ka bere koment te ngjashem edhe per piken e fundit te nenit 6.

Qëndrimi i AKEP

Afatet per kthimin e pergjigjeve jane pjese e procedurave dhe shkelja e tyre perben shkelje te procedurave. Gjithsesi eshte AKEP qe do te vleresoje arsyet e mos-kthimit te pergjigjes. Operatori i infrastruktures duhet ne cdo rast te ktheje nje pergjigje brenda 30 diteve nga marrja e kerkeses.

Komente te Albtelecom

Përsa i përket **nenit 7** “*Tarifat dhe pagesat për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës*”, Albtelecom gjykon se do të ishin të nevojshme disa ndërhyrje për të përkufizuar dhe për të pasqyruar në mënyrë me të qartë përcaktimet kryesore në lidhje me këto elementë thelbësorë të rregullores sic janë tarifat dhe pagesat, rrjedhimisht Albtelecom kërkon që të bëhen ndryshimet si më poshtë; **Pika 1/c, e nenit 7**, të modifikohet:

“...Jenë reciproke për të njëjtin shërbim: kërkuesi dhe ofruesi i infrastrukturës paguajnë të njëjtën tarifë për shërbime të njëjta të ofruara njëri-tjetrit në kushte dhe rrethana të njëjta”.

Albtelecom sugjeron që për pikën 5 neni 7, në lidhje me tarifat për qeranë mujore...do të ishte shumë e vlerësueshme nëse AKEP do të gjentë mundësinë të sqaronte cili është kuptimi dhe lidhja llogjike (nëse kanë) ndërmjet pikave a) dhe b) të kësaj pike 5. Gjithashtu do të ishte mirë nëse ky sqarim do të ilustrohej edhe me shëmbuj hipotetik.

Në lidhje me **pikën 7 të nenit 7**, Albtelecom gjykon se përcaktimet në pikat **a, b, c, d, f**, dhe **g** ofrojnë të gjitha siguritë për operatorin në rastin e përcaktimit nga ana e AKEP e një çmimi të drejtë dhe të arsyeshëm për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës kur ky cmim nuk ka mundur të arrihet në marrëveshje të lirë ndërmjet palëve. Shërbimet e përdorimit të përbashkët të infrastrukturës janë shërbime ndihmëse apo facilitete shtesë që i ofrohen apo sigurohen operatorit përfitues për nevojat e tyre apo për t'i mundësuar ofrimin pikërisht të shërbimeve bazë/standarte te telekomunikacioneve ndaj konsumatorit. Nga ku, subjekt i rregullave dhe parimeve të vendosura në Rregulloren Nr.32 “Për ndarjen e llogarive...” janë pikërisht shërbimet nën rregullim të telekomunikacioneve dhe jo shërbimet ndihmëse të infrastrukturës apo fasilitetet shtesë për të cilat po draftohet kjo Rregullore.

Prandaj, Albtelecom kërkon të hiqet në tërësi **shkronja e)** nga përcaktimet e **pikës 7 të nenit 7**, dhe në rast se AKEP gjykon të nevojshme në mënyrë të domosdoshme referencën në koston e shërbimeve, atëherë Albtelecom sugjeron që kjo pikë të rishikohet duke u kufizuar vetëm në:

Neni 7, pika 7,e) “Orientimin në kosto të tarifave për përdorimin e përbashkët nga ofruesi i infrastrukturës, duke marrë parasysh kostot historike”.

Qëndrimi i AKEP

AKEP ka pranuar sugjerimin e Albtelecom për vendosjen e shprejës *ne kushte dhe rrethana te nejtja*. AKEP ka bere disa ndryshime ne nenin 7 te draft-rregullores (neni 8 ne versionin final), perfshire dhenien e detajeve per piken 5. Qellimi i percaktimeve ne piken 5 eshte qe tarifimi i nje operatori per nje kabell duhet te jete ne varesi te proporcionit qe ze kablli/nen-tubi i operatorit

perfitues ne tubin e operatorit te infrastruktures. Shprehja e tarifave ne km dhe cm2 synon të lehtësojë këtë process që cdo operator ta dijë sa do paguajë në varësi të diametrit të kabllit.

Komente të Abissnet

Në rregullore, në Nenin 5 pika 2 Procesi për lidhjen e marrëveshjes për përdorimin e përbashkët të tubacioneve, trajtohet afati brenda të cilit Operatori i Infrastrukturës duhet të shqyrtojë kerkesën e depozituar të Operatorit Përfitues. Sipërmarrësi "Abissnet" sh.a. vlerëson që afati prej 15 ditësh për sa i përket informimit me shkrim për mundësinë apo pamundësinë e Operatorit Përfitues, të përdorimit të përbashkët të tubave kabllorë është i pamjaftueshëm, kjo për arsyet si më poshtë vijon:

- Procedurat e verifikimeve në terren të gjendjes teknike të tubacioneve dhe rrjetit të Operatorit të Infrastrukturës zgjasin më tepër se 15 ditë
- Komplexiteti që paraqet vetë nderhyrja në rrjet, kërkon përzgjedhjen me kujdes të veçantë të Operatorëve Përfitues.

Sipërmarrësi Abissnet sh.a. sugjeron një afat nga 30 ditë deri në 45 ditë.

Qëndrimi i AKEP

AKEP pranon sugjerimin e Abissnet dhe ka bere ndryshimin e afatit te cituar nga 15 dite ne 30 dite.

Komente të Abissnet

Abissnet propozon të shtohet nje Dispozitë, ku të parashikohet që Operatori i Infrastrukturës nuk mban përgjegjësi për dëmet që mund t'i shkaktohen rrjetit të Operatorit Përfitues për shkaqet e mëposhtme:

- a. Në rast të dëmeve të shkaktuara nga "Forca Madhore";
- b. Në rast të dëmtimeve të infrastrukturës nga të trete në segmente të ndryshme si pasojë e punimeve që mund kryejnë;
- c. Nga çfaredolloj ndërhyrje që nuk varet nga Operatori i Infrastrukturës.

Qëndrimi i AKEP

AKEP ka perfshire sugjerimin e Abissnet ne Nenin 8 të rregullores (version final).

Komente të Abissnet

Referuar kompleksitetit qe paraqet nderhyrja ne rrjetin e Operatorit te Infrastruktures, **Abissnet** sugjeron qe Operatori Perfitues te procedoje me venien ne dispozicion te nje Garancie Bankare, e cila te sherbeje per mbulimin e gjithë demeve qe mund t'i shkakohen rrjetit te Operatorit te

Infrastrukures nga nderhyrja e Operatorit Perfitues, apo per demshperblimin per zgjidhjen e parakoheshme te Kontrates.

Per arsye te investimit qe ben Operatori i Infrastruktures dhe planifikimit afatmesem dhe afatgjate ne dobi te zgjerimit te rrjetit te parashikohet nje limit kohor per prishjen e kushteve te Marreveshjes mes Operatorit te Infrastruktures dhe Operatorit Perfitues, Abissnet sh.a. propozon qe afati minimal i kohezgjatjes se marreveshjes te jete te pakten 2 (dy) vjecar.

Kerkesa per zgjidhjen apo ndryshimet e kushteve te kontrates te behet me shkrim te pakten 6 (gjashte) muaj me pare.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP nuk e ndalon vendosjen e garancive bankare. Rregullorja permban disa pika qe duhet te permbaje marrveshja per perdromin e perbashket te facilitateve por palet mund ti referohen edhe marrveshjeve te akses/interkoneksionit per modele marreveshjesh. AKEP gjithsesi ka perfshire dy pika te reja ne nenin 9, pika 3, ne lidhje me afatin e marrveshjeve dhe mundesite e vendosjes se garancive.

Komente të Abissnet

Abissnet sh.a. propozon qe, ne rregullore, te parashikohet e drejta e Operatorit te Infrastruktures te refuzoje kerkesen per perdromin e perbashket te tubacioneve, nese tubacioni qe eshte i ndertuar, eshte ne proces legalizimi ose akoma nuk eshte i plotesuar me te gjitha lejet e nevojshme kjo referuar problematikave ligjore qe mund te lindin nga fakti qe nje pjese e tubacioneve mund te jene ne proces legalizimi,

Abissnet sh.a. propozon qe te jete detyre e Operatorit Perfitues te paraqese vertetimin e autorizimit te perdromit te frekuencave, vertetim i marre nga AKEP, ne momentin e marreveshjes per perdromin e perbashket te kullave. Mungesa e autorizimeve, qe autorizojne Operatorin e Infrastruktures per te operuar ne fushen e komunikimeve elektronike, t'i jape te drejten Operatorit te Infrastruktures te refuzoje marreveshjen.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP ka marre ne konsiderate propozimin per vertetimin e autorizimit individual per perdromin te kullave, por nuk ka nevojte qe AKEP te leshoje vertetime per autorizimet qe leshon. Per frekuencat secili operator ka autorizim individual dhe kjo mjafton si vertetim. Ne lidhje me kerkesen e pare, per mos-dhenie aksesit nese nuk eshte legalizuar ende tubi, AKEP nuk e pranon pasi ne te kundert do te nxiste ndertimin jo-legal te infrastruktures dhe mos-ndarjen e saj me te tjeret.